



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
 VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)

- **Nga:** Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

- **Datë:** 16 janar 2023
- **Lënda:** RAPORT VJETOR PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR VITIN 2022

Gjykata Supreme e ka përmbyllur vitin 2022 me 1.636 lëndë të kryera, derisa janë trashëguar për vitin 2023, vetëm 201 sosh.



1. Raport vjetor 2022, shprehur në përqindje

Gjatë vitit 2022 në punë kanë qenë gjithsej 1.837 lëndë. Rrjedh se numrin më të madh të lëndëve të kryera gjatë kësaj periudhe raportuese e përbëjnë Revizionet (R) me 679 lëndë të kryera, duke u renditur pas tyre Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë (PML), me 520 lëndë të kryera dhe Kërkesat për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm Administrativ (ARJ) me 126 lëndë të kryera.

Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshijnë:

520 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë,

679 Revizione,


108 Revizione ekonomike.

114 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

126 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ


34 ankesa administrative.

E paraqitur ne grafikun, duket kështu:




2.Lëndët e kryera, sipas kërkesave të pranuara

E kalkuluar në përqindje, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, del të jetë 114.18 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.



3. Efikasiteti i kryerjes së lëndëve

Krahasuar me vitin 2021, shkalla e efikasitetit të Gjykatës Supreme është rritur për 15.07 për qind, pasi, në vitin 2021, efikasiteti në kryerjen e lëndëve, ishte prej 99.11 për qind, ndërkohë që këtë vit ky efikasitet është 114.32 për qind.



4. Rritja e efikasitetit të punës, shprehur në përqindje

Seancat e Përgjithshme të Gjykatës Supreme

Gjatë vitit 2022, janë mbajtur tri Seanca të Përgjithshme të Gjykatës Supreme, në të cilat kanë marrë pjesë gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe ata të Dhomës së Posaçme të kësaj gjykate.

Në Seancën e parë të Përgjithshme, është miratuar:

- **Plani dhe Programi i punës për vitin 2022¹.**

Në Seancën e dytë të Përgjithshme, me shumicë votash është aprovuar:

- **Mendimi Juridik për kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit dhe dëmeve të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim².**

Ndërkaq në Seancën e Përgjithshme, të tretë dhe të fundit për vitin 2022, unanimisht, janë aprovuar;

- **Mendimi Juridik lidhur me shlyerjen grupore (shlyerjen në bllok) nga evidenca penale të të gjitha dënimeve që janë shqiptuar nga gjykatat në Kosovë që nga viti 1999 e tutje,**
- **Qëndrimi Parimor lidhur me kontestet e punës dhe**
- **Udhëzuesi lidhur me rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor³.**

Po ashtu, në fund të muajit dhjetor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në bashkëpunim me Gjykatën Supreme ka publikuar Përmbledhjen⁴ me një numër të Mendimeve Juridike dhe Udhëzuesve, botim ky që u mundësua falë mbështetjes nga Projekti i USAID për Drejtësi (Justice Activity) dhe Projekti i Bashkimit Evropian për Evidencën Penale (NCCR) .

¹ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/plani-i-punes/>

² <https://supreme.gjyqesori-rks.org/mendimet-juridike/>

³ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/korniza-ligjore/udhezimet-administrative/udhezimet/>

⁴ https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/93618_Permbledhje_e_Mendimeve_Juridike_Udhezues_te_Gjykates_Supreme_te_Kosoves_dhe_Opinone_te_Komitetit_Keshilledhenes_per_Eti.pdf

Caktimi i U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme

Me datë 14 dhjetor 2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka caktuar gjyqtaren Mejreme Memaj ushtruese të detyrës së kryetares së Gjykatës Supreme. Ky caktim është bërë pas lirimimit nga detyra të kryetarit të deriatëhershëm, Enver Peci, i cili dha dorëheqje, pasi me datë 24 nëntor 2022, Kuvendi i Kosovës e propozoi për dekretim tek Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Gjyqtarja Memaj, nga data 14 dhjetor 2022 është U.D. kryetare, deri në zgjedhjen dhe emërimin e kryetarit/es së Gjykatës Supreme⁵.

Pensionimet dhe avancimet gjatë vitit 2022

Në mars të vitit 2022, tre (3) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, Zenel Leku, Rrustem Thaqi dhe Nenad Lazic, janë avancuar në Gjykatën Supreme. Dy të parët i janë bashkuar degës civile, ndërsa i fundit Kolegjit të Apelit, (i cili vendos lidhur me vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Agjencisë Kosovare të Pronave dhe Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës), nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Po ashtu, në muajin shtator, në kuadër të procesit të avancimit për gjyqtarë, Gjykatës Supreme i janë shtuar edhe dy (2) gjyqtarë; Afrim Shala, në degën penale dhe Milena Đerić, në degën civile.

Ndërkaq, në pension kanë dalë dy gjyqtare. Gjyqtarja Nesrin Lushta, e cila kishte mbi 14 vite përvojë pune në Gjykatën Supreme, dhe gjyqtarja Jelena Krivokapić, me rreth 5 vite përvojë pune në Gjykatë Supreme.

Po ashtu, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, janë pensionuar dy (2) gjyqtarë; Hamdi Ibrahimimi dhe Čerim Fazliji.

⁵ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/12/14/keshilli-gjyqesor-i-kosoves-ka-caktuar-gjyqtaren-mejreme-memaj-ushtrues-te-detyres-se-kryetares-se-gjykates-supreme/>

Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore

Komisioni konsultativ për Politikë Ndëshkimore, gjatë vitit 2022, ka vazhduar punën, takimet dhe vizitat studimore.

Janë mbajtur tryeza diskutimi e janë zhvilluar takime të Komisionit me profesorë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe me përfaqësues të shoqërisë civile⁶; takime në të gjitha gjykatat themelore dhe në atë të Apelit⁷; vizita studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës⁸, etj..

Komisioni, gjatë vitit 2022, fokusin kryesor e ka pasur në revidimin e Udhëzuesit të Përgjithshëm për Politikë Ndëshkimore.

⁶ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/06/01/komisioni-per-politike-ndeshkimore-diskuton-me-shoqerine-civile-per-revidimin-e-udhezuesit-te-pergjithshem/>

⁷ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/09/07/reforma-e-politikes-ndeshkimore-fokusi-te-gjykata-e-apelit/>

⁸ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/09/21/komisioni-per-politike-ndeshkimore-vizite-studimore-ne-shba-2/>

Komunikimi dhe transparenca në Gjykatën Supreme, gjatë vitit 2022

Komunikimi, transparenca dhe qasja e lehtë e qytetarëve në shërbimet e Gjykatës, ka qenë një prej prioriteteve të Gjykatës Supreme. Kjo dëshmohet përmes statistikave të mbledhura, të cilat pasqyrohen si në vijim:

221 - palë përgjigje në pyetjet e mediave, OJQ-ve, palëve dhe qytetarëve, prej tyre:


60 - kërkesa - krijim i qasjes në dokumente publike, vetëm një (1) kërkesë e refuzuar.

3.190 - aktgjykime dhe aktvendime të publikuara në ueb-faqen e Gjykatës

9 - vendime disiplinore të publikuara⁹.

45 - komunikata për media dhe postime në ueb-faqe.

87 - postime dhe shpërndarje në faqen e Gjykatës në rrjetin social Facebook.



⁹ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/vendimet-disiplinore/>

Publikimi i vendimeve

Gjatë vitit 2022, Gjykata Supreme ka vazhduar me publikimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve. Kështu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar gjithsej 3.190 vendime, prej tyre 2.064 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme¹⁰.

E paraqitur në grafikon, për secilin muaj, publikimi i vendimeve, duket kështu:



Publikimi i vendimeve

¹⁰ <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

| RAPORT PËR PUNËN NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS NË PRISHTINË | | | | | |
|---|-------------|-------------|------------------|-------------|-------------|
| PËR PERIUHDHËN 1.01.2022 DERI MË 31.12.2022 | | | | | |
| | Të pakryera | Të pranuar | Gjithsej në punë | Të kryera | Te pakryera |
| Ankesa penale për shkallën e tretë "PA" | 0 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML" | 12 | 528 | 540 | 520 | 20 |
| Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD" | 1 | 118 | 119 | 114 | 5 |
| Revizion "Rev" "Rev II" | 327 | 489 | 816 | 679 | 137 |
| Mbrojtje e ligjshmërisë "CML" | 4 | 20 | 24 | 15 | 9 |
| Përsëritje e procedurës civile "CPP" | 0 | 2 | 2 | 2 | 0 |
| Civile të ndryshme "CN" | 0 | 7 | 7 | 5 | 2 |
| Revizione ekonomike "E.Rev" | 61 | 61 | 122 | 108 | 14 |
| Mbrojtje e ligjshmërisë "EML" | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| Përsëritje e procedurës administrative "APP" | 0 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML" | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| A.Rev. | 0 | 6 | 6 | 6 | 0 |
| ARJ | 0 | 136 | 136 | 126 | 10 |
| Ankesa administrative "AA" | 0 | 37 | 37 | 34 | 3 |
| Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "KML" | 0 | 6 | 6 | 5 | 1 |
| Ankesa për paraburgime "PN.II" | 0 | 15 | 15 | 15 | 0 |
| Penale Ndihme Juridike Nderkombetare "PNJD" | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Administrative të ndryshme "AN" | 0 | 3 | 3 | 3 | 0 |
| Gjithsej | 406 | 1431 | 1837 | 1636 | 201 |